



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA JURIDIKE
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ prot.

Vlorë, më ____ . ____ .2025

PROCESVERBAL-Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE
TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**
(Ky procesverbal është përfekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje makine zjarrfikëse e re”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 34144210-3 -
Automjete zjarrfikëse**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 29,166,667.00 (njëzet e nëntë milion e njëqind e gjashtëdhjetë
e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH.**

**VLERA E FONDIT LIMIT NË EURO: 301,651.33 (treqind e një mijë e gjashtëqind e
pesëdhjetë e një .33) Euro pa TVSH**

*Shënim: Konvertimi i monedhës Lekë në Euro është bërë sipas kursit zyrtar të bankës së
Shqipërisë Datë 13.11.2025 ku 1 Euro këmbëhet me 96.69 Lekë.*

**Për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin Nr. 162/2020, datë
23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe VKM Nr 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e
Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 76, pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe studimit
te tregut, fondi limit u përlllogarit bazuar në mesataren e cmimeve të marra nga ky studim.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 2, pika 2/c dhe neni
78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik”, autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: “...*Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...*”

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4.*

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me:

- Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) me Kodin VII.3.B për pikën, “Shit-blerje e mjeteve rrugore me motor dhe/ose e rimorkiove të reja ose të përdorura” sipas udhëzimit të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 2 të ligjit me nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ligji me nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 40, pika 5, gërma a) të VKM me nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, VKM me nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët

ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të prokuruar.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43 pika 1, pika 2/b dhe pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar “Kerkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 1 citon: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, ndërsa në pikën 2/b citohet: vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, ndërsa në pikën 3 citohet: Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor, për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Gjithashtu vendosja e kriterëve në reference është bërë që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, në nenin 77, pika 3 e LPP, në nenin 43 pika 1, pika 2/b dhe pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë” i ndryshuar, si edhe në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Në percaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2/b, të Nenit 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). *(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).*

***Shënim:** Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Kjo kërkesë është bërë në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, sipas të cilit, operatorët ekonomikë duhet të shlyejnë detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në çdo adresë ku ushtrojnë aktivitet.

2.2.3 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore të 3(tre) viteve të fundit (2022, 2023, 2024) të çertifikuara nga organet tatimore si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Shënim: Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës

kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitetet financiar për zbatimin e kontratës

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 30% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 30% e vlerës së përllogaritur të kontratës që po prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 30% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vlera e kërkuar është vendosur që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- **ISO 9001:2015 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent;**

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “*Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë*”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “*Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit*”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

2.3.3 Operatori ekonomik të dorëzojë në SPE certifikatë konformiteti/ katalog/skeda teknike, ku të pasqyrohen të dhëna të plota të mjetit objekt prokurimi, në mënyrë që AK të mund të kryej verifikimin e të gjithë kërkesave teknike të kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Vendosija e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga AK me specifikimet teknike për mjetin e ofruara nga operatori ekonomik.

- 2.3.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesë në SPE autorizim prodhuesi dhe distributor i autorizuar, me të dhëna të sakta të prodhuesit. Ky dokument duhet të përmbaj adresë të saktë email dhe numër telefoni të shoqërisë e cila lëshon autorizimin, në mënyrë që AK të kryej verifikimet e posacme.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm i cili garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të mallit objekt prokurimi. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallit që kërkohen të blihen e që është prodhuar në përputhje me standartet. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

- 2.3.5** Automjeti që ofrohet duhet të jetë i pajisur me Certifikatë të Konformitetit European (Certificate of Conformity – COC), të lëshuar nga prodhuesi në përputhje me direktivat dhe standartet e Bashkimit European për automjetet rrugore. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë autorizimin e prodhuesit/distributorit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Kërkesa që automjeti zjarrfikës të jetë i pajisur me Certifikatë të Konformitetit European (Certificate of Conformity – COC) është një element thelbësor për garantimin e cilësisë, sigurisë dhe përputhshmërisë teknike të mjetit me standartet ndërkombëtare. COC është një dokument zyrtar i lëshuar nga prodhuesi i automjetit, i cili vërteton se mjeti përmbush të gjitha kërkesat teknike dhe mjedisore të përcaktuara në direktivat e Bashkimit European për automjetet rrugore.

2.3.6 Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku merr përsipër dorëzimin e mjetit në vendin e caktuar nga AK, brenda afatit të dorëzimit sikundër kërkohet në DST si dhe paisjen e mjetit me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të qenë gati për të qarkulluar.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, 40, pika 8. Vendosija e kriterit, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për t’u garantuar se mjeti do të dorëzohet pranë AK i pajisur me të gjithë dokumentacionin e rregullt tekniko-ligjor, i gatshëm për qarkullim rrugor në emër të AK-së.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë që garanton mbulimin e periudhës së garancisë së mjeteve për defekte të Sistemit elektrik/ Sistemit motorrik/ Sistemi i drejtimit/ Sistemi i frenimit, për një periudhë 1 vjecare duke filluar nga data e marrjes në dorezim të mallrave objekt i këtij prokurimi.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, 40, pika 8. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe zërave të preventivit objekt i kontratës.

Argumentimi i specifikimeve teknike : Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistët e fushës, bashkëngjitur DST në SPE.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur

nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJËSIA E PROKURIMIT